

RAPORTI I KONSULTIMEVE PUBLIKE

Komuna: Gjilan

JANAR 2026

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive	2
1. Raporti për takimet publike me qytetarë	3
2. Raporti për konsultimet publike për projektaktet komunale (takimet konsultative)	11
3. Raporti për konsultimet publike me shkrim apo elektronike (përdorimi i platformës së konsultimeve)	13
4. Raporti i dëgjimeve buxhetore me qytetarë.....	14

Përmbledhje ekzekutive

Përmes këtij Raporti përmbledhës të Konsultimeve Publike synohet që të dokumentohen të gjitha format e konsultimit publik që i kanë paraprirë përpilimit/draftimit të projekt-propozimit të buxhetit nga ana e ekzekutivit të komunës. Kjo nënkupton që përfshihen takimet publike obligative të mbajtura në gjashtëmuorin e parë nga ana e Kryetarit, format e konsultimit publik në të shkruar, dëgjimet buxhetore për KAB, për buxhetin 2026 dhe buxhetimin me pjesëmarrje.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna 04/2023, Komuna siguron përfshirjen e qytetarëve në konsultime dhe vendimmarrje duke përdorur por duke mos u kufizuar në mbajtjen e: 1.1 Takimeve publike; 1.2 Konsultim publik për projekt aktet normative dhe dokumente të politikave; 1.3 Takime konsultative me qytetarë; 1.4 Dëgjime buxhetore.

1. Raporti për takimet publike me qytetarë

Në bazë të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna 04/2023, përcaktohen rregullat që sigurojnë përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve përfaqësuese në vendimmarrje lokale, transparencën dhe llogaridhënien e organeve të komunës, gjithashtu përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave dhe akteve nënligjore në komunë si dhe obligimet e komunave për të siguruar qasjen nëpërmjet teleprezencës dhe teknologjisë digjitale për të garantuar transmetimin në distancë dhe monitorimin nga autoritetet qendrore, shoqëria civile dhe qytetarët. Sipas këtij Udhëzimi, Komuna duhet të siguroj përfshirjen e qytetarëve në konsultime dhe vendimmarrje duke përdorur por duke mos u kufizuar në mbajtjen e: 1.1 Takimeve publike; 1.2 Konsultim publik për projekt aktet normative dhe dokumente të politikave; 1.3 Takime konsultative me qytetarë; 1.4 Dëgjime buxhetore.

Me qëllim të dokumentimit të mbajtjes së takimeve, konsultimeve publike, dëgjimeve buxhetore dhe takimeve tjera, komuna siguron ftesat, materialet, sigurimin e kushteve, mbajtjen e procesverbalit dhe hartimin e raportit nga takimet dhe aktivitetet e përfshirjes së qytetarëve në diskutime dhe konsultime publike, gjatë hartimit të akteve dhe dokumenteve lokale. Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt- propozimit gjatë mbajtjes së konsultimit publik mbledh komentet dhe përgatit raport për rezultatet e konsultimit publik.

Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, respektivisht Nenit 60, përcaktohet se përgatitja dhe rishqyrtimi i propozim-buxheteve dhe kërkesave për ndarje buxhetore bëhet nga Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) dhe Kryetari i Komunës, ku ZKF duhet, me ose para 1 Korrikut të vitit aktual kalendarik, t'i dërgojë kryesuesit të secilit departament komunal të komunës një qarkore buxhetore komunale e cila përmban informata dhe udhëzime mbi:

- (i) tavanet e shpenzimeve të aplikueshme për departamentin përkatës për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësime mbi këto tavane për dy (2) vitet e ardhshme fiskale, dhe
- (ii) metodologjinë dhe formularët që duhet të shfrytëzohen nga departamenti përkatës gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal. Kjo qarkore buxhetore duhet të përfshijë: a) procedurat që duhet përdorur nga departamenti gjatë përgatitjes së propozim buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore; b) të dhënat të cilat duhet të parashtrohen në propozim-buxhet dhe në kërkesën për ndarje buxhetore; c) detale mbi formatin në të cilin duhet të përgatitet propozim-buxheti dhe kërkesa për ndarje buxhetore; dhe d) afatin e fundit deri në të cilin departamenti duhet të përfundojë dhe t'i dorëzojë ZKF-së propozimbuxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore.

Pas miratimit të propozim-Buxhetit Komunal nga kryetari i Komunës, kryetari i Komunës, deri me 1 shtator të vitit përkatës fiskal, duhet t'ia dorëzojë këto dokumente Kuvendit Komunal. Propozim-Buxheti Komunal duhet të përfshijë:

- a) parashikime dhe supozime ekonomike dhe buxhetore;

- b) vlerësime të përgjithshme të të ardhurave nga të gjitha burimet, duke përfshirë (i) grantet, në përputhje me shumat e këshilluara në qarkoren(t) buxhetore të nxjerra nga Ministri, (ii) ndihmën nga burimet jashtë Kosovës, dhe (iii) të ardhurat e parashikuara vetanake të komunës;
- c) një cak të përgjithshëm të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimit;
- d) vlerësime të përkrahjes së pritur nga donatorët; dhe
- e) çfarëdo të dhëna të tjera me rëndësi materiale për buxhetin të cilat ZKF e konsideron të arsyeshme për t'u përfshirë.

1.1 ECURIA E PROCESIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PLANIFIKIMIN DHE PËRPILIMIN E PROPOZIM-BUXHETIT KOMUNAL

Dëgjimet publike për buxhetin e vitit 2026 janë organizuar nga grupi punues i themeluar me vendim të Kryetarit në vitin 2025, në harmoni me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës dhe kompetencat dhe përgjegjësitë e komunave: Ligjin për vetëqeverisjen lokale, Ligjin për financat e pushtetit lokal, Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë të Hapur në Komunë.

*Në muajin maj janë organizuar dëgjimet buxhetore për **Buxhetimin me Pjesëmarrje**, në qershor dëgjimet për **Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028** dhe në korrik dëgjimet për **Buxhetin 2026**.*

Buxhetimi me Pjesëmarrje si formë e re e planifikimit dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimarrjen lokale është organizuar në Komunën e Gjilanit gjatë muajit maj me katër lagje të qytetit: lagjja “Zabeli”, “Tregu i Gjelbër”, “Rruga e Prishtinës”, “Lagjja e Tetë”; tri fshatra: Pogradja, Livoçi i Epërm, Gumnishta dhe me grupin e grave. Lagjet që janë përfshirë në këtë formë buxhetimi ishin më pak të përfshira në investime në vitet e fundit, ndërsa grupi i grave ka marrë pjesë edhe kësaj radhe, për të dytën herë në Buxhetimin me pjesëmarrje, sepse ky vit është shpallur Vit i Gruas në Kosovë, nga Kryeministri i Republikës, Albin Kurti. Fondet për tetë projektet që kanë dalë nga ky proces i buxhetimit, janë rritur nga 280 mijë euro sa ishin në vitin 2024, në 400 mijë euro për vitin 2025.

Përmes kriterëve që kemi vendosur për Buxhetimin me pjesëmarrje kemi synuar gjithëpërfshirjen dhe barazinë:

- Lagjet dhe fshatrat me më pak investime në 5 vitet e fundit dhe me më shumë nevoja për investime,
- numri i madh i banorëve përfitues,
- komuniteti i grave,
- një lokalitet me më pak banorë dhe në distancë më të largët nga qendra dhe
- komunitetet me mungesë të infrastrukturës bazë.

Kriteret për llojin e projekteve: të jetë nga investime kapitale, projekt-propozimi të jetë brenda kornizave të buxhetit të prezantuara nga komuna, numri i përfituesëve nga projekti i propozuar të jetë sa më i madh, sidomos në rastet e barazimit të votave, projekti të ketë ndikim social, ekonomik dhe mjedisor, projekti të jetë gjithëpërfshirës duke përfshirë grupe të marginalizuara, veçanërisht gratë dhe të rinjtë, lokacioni i projektit të propozuar të jetë në pronësi të komunës ku disponueshmëria konfirmohet zyrtarisht nga komuna dhe vlera e projektit të jetë 50 mijë euro.

Dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore janë mbajtur gjatë muajit qershor në tri terminë: me banorë të fshatrave të komunës, lagjet e qytetit dhe grupet e grave, të rinjve, komuniteteve jo- shumicë, personave me nevoja të veçanta dhe të tjerë.

Dëgjimet publike për Buxhetin 2026 - Procesit të Dëgjimeve buxhetore iu ka paraprirë fushata informuese. Njoftimet për konsultime publike janë publikuar në rrjete sociale, portale lokale dhe përmes posterëve njoftues të vendosur në institucione publike, në drejtori të Administratës, pranë Kuvendit Komunal, në zyrat e gjendjes civile në lokalitetet e përfshira, ambulanta dhe qendra të mjekësisë familjare, shkolla fillore dhe kampusin e shkollave të mesme, dhe në Universitetin Publik të Gjilanit “Kadri Zeka”.

Në takime kanë marrë pjesë kryetari i Komunës, nënkryetarët, kryesuesi i Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të subjekteve politike-grupeve të përfaqësuara në Kuvend, pjesëtarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, zyrtarë dhe qytetarë. Nga përfaqësuesit e këshillave lokal kemi pranuar edhe në formë të shkruar kërkesat me listën e projekteve të nevojshme për lokalitetet përkatëse, të cilat më pas përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë i kemi adresuar tek drejtoritë përkatëse, kryesisht tek Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe një kërkesë tek ajo e Arsimit, për çerdhen në fshatin Velekincë, që e kemi pranuar në dëgjimet për Buxhetin 2026, në takimin e mbajtur në gusht në këtë fshat.

Tabela 1. Raportit për takimet publike me qytetarë

Tabela e përgjithshme					
Komuna	Numri i takimeve publike me qytetarë të organizuara	Numri i pjesëmarrësve në takimet publike (në total)	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M. / F)		Numri i procesverbaleve të hartuara dhe publikuara pas takimeve
Komuna e Gjilanit	30	392 pjesemarrës në degjimet buxhetore dhe Rreth 200 pjesemarrës në takimet publike të kryetarit me qytetarët	328	64	3 raporte përmbledhëse të konsultimeve publike https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/ https://gjilan.rks-gov.net/news/kryetari-alban-hyseni-prezantoi-raportin-e-punes-per-gjysmen-e-pare-te-ktij-viti-te-komunes-se-gjilanit/ https://gjilan.rks-gov.net/news/kryetari-hyseni-prezantoi-para-qytetareve-raportin-vjetor-te-punes-per-vitin-2025/

Verifikimi i të dhënave			
Takimi publik	Data e takimit	Linku i njoftimit të publikuar	Linku i procesverbalit
Zabeli	14.05.2025 takimet e para	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Rruga e Priishtinës	15.05.2025	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Lagja e 8	16.05.2025	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Tregu i gjelbër	19.05.2025	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Livoç i Epërm	20.05.2025	Kalendari-i-Buxhetimit-me-	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/

		Pjesemarrje-2025.pdf	
Pogragjë	21.05.2025	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Gumnishtë	22 maj	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Gratë	23 maj	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Zabelit	26 maj- takimi e dyta votimi	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Rr e Prishtinës	26 maj	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Lagjja e 8	27 maj	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Tregu i gjelbër	27 maj	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Livoç i Epërm	28 maj	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Pogragjë	29 maj	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Gratë	30 maj	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/

Gumnishtë	30 maj	Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Banorët e fshatrave	13 qershor KAB	Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-KAB-2025-2027.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Rinia, gratë, sportistët, art, kulturë, personat me aftësi dhe komunitetet jo shumicë	13 qershor	Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-KAB-2025-2027.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Lagjet e qytetit	13 qershor	Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-KAB-2025-2027.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Banorët e Llashticës, Lladovës, Nasalës, Lipovicës, Burincës dhe Muqibabës	23 korrik-buxheti 2026	Njoftim-Degjimi-buxhetor-me-banoret-e-Llashtices-e-Lladoves-me-23-korrik-2025-ora-17-00.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Banorët e Zhegrës, Pidqit, Stanqiqit, SHurdhanit, Selishtës, Isufajt, Seferajt, Godenit, Dunavit, Haxhajt, Demirajt dhe Çelikut	23 korrik	Njoftim-Degjimi-buxhetor-me-banoret-e-Llashtices-e-Lladoves-me-23-korrik-2025-ora-17-00.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Banorët e Pogradjës, Bilinicës, Llovcës, Kokajt, Sllubicës dhe Stublinës	24 korrik	Njoftim-Degjimi-buxhetor-me-banoret-ne-Pogradje-Bilince-Llovce-Kokaj-Sllubice-e-Stubline-me-24-	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/

		korrik-2025-17-00.pdf	
Banorët e Kishnapolës, Gadishit dhe Sllakovcit	25 korrik	Njoftim-Degjimi-buxhetor-me-banoret-ne-Kishnapole-Gadish-e-Sllakoc-me-25-korrik-2025-14-00.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Banorët e Bresalcit, Poneshit, Gllamës, Livoçit Epërm, Verbicës dhe Zhegovcit	25 korrik	Njoftim-Degjimi-buxhetor-me-banoret-ne-Bresalc-Gllame-e-Ponesh-me-25-korrik-2025-17-00.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Banorët e Përlepnicë, Kmetovcit, Shillovës, Verbicës dhe Dobërçanit	28 korrik	Njoftim-Degjimi-buxhetor-me-banoret-ne-Perlepnice-Kmetoc-Shillove-Berbice-e-Kmetocit-e-Dobercan-me-28-korrik-2025-14-00.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Komunitetet jo shumicë	28 korrik	Njoftim-Degjimi-buxhetor-me-komunitetet-jo-shumice-me-28-07-2025-16-00.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Banorët e Cërrnicës, Gumnishtës, Kravaricës dhe Livoçit e Ulët	29 korrik	Njoftim-Degjimi-buxhetor-me-banoret-ne-Cernice-Gumnishte-e-Kravarice-me-29.07.2025-14-00.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Me gratë	29 korrik	Njoftim-Degjimi-buxhetor-me-grate-me-	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/

		29.07.2025-16-30.pdf	
Me banorët e qytetit	30 korrik	Njoftim-Degjimi-buxhetor-me-banoret-e-qytetit-me-30.07.2025-17-00.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Me shoqërinë civile	30 korrik	Njoftim-Degjimi-buxhetor-me-shoqerine-civile-me-30.07.2025-14-00.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/

2. Raporti për konsultimet publike për projektaktet komunale (takimet konsultative)

Konform nenit 26 të UA për Administratë të Hapur, Komuna e Gjilanit ka organizuar konsultimet publike duke publikuar njoftimet dhe takimet në ueb-faqen e komunës dhe në Platformën e Qeverisë për Konsultime publike. Gjatë procesit palët e interesuara kanë adresuar edhe përmes shkresave fizike kërkesat e tyre, të cilat më pas janë perçjellë për trajtim në njësitë përkatëse dhe drejtoritë komunale.

Grupet e targetuara në konsultimet publike gjatë vitit 2025 janë:

Grate, të rinjtë, komuniteti sportiv, artistët, komunitetet jo-shumicë, personat me aftësi të kufizuara, fermerët, pensionistët, shoqëria civile etj.

Tabela 2. Raportit për konsultimet publike për projektaktet komunale (takimet konsultative)

Tabela e përgjithshme								
Komuna	Plani i konsultimeve është hartuar dhe publikuar në fillim të vitit (PO/JO)	Numri total i akteve komunale të miratuara, për të cilat kërkohet organizimi i konsultimit publik	Numri i projektakteve për të cilat është organizuar konsultim publik	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (total) (M. F)		Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar komente gjatë konsultimit	Numri i rekomandimeve/propozimeve të pjesëmarrësve të aprovuara	Numri i raporteve të konsultimit të hartuara dhe publikuara
Komuna e Gjilanit	Po	30	3	32	64	312	8	3 raporte

Verifikimi i të dhënave			
Emërtimi i Projektaktit	Data e mbajtjes së konsultimit	Linku i njoftimit të publikuar	Linku i publikimit të raportit
Buxheti 2026	23.07.2025-30.07.2025	https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Kalendari-i-Degjimeve-Buxhetore-per-Planifikimin-Buxhetor-2026-2028-3.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/degjimet-buxhetore-2/
Buxhetime pjesëmarrje 2025	14 Maj deri më 30 Maj	https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Kalendari-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Raporti-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf

KAB 2025/2027	13.06.2025	https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-KAB-2025-2027.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/raporti-i-degjimeve-publike-per-kab-2026-2028/
--------------------------	-------------------	--	--

3. Raporti për konsultimet publike me shkrim apo elektronike (përdorimi i platformës së konsultimeve publike dhe ueb faqes zyrtare të komunes)

Në komunën e Gjilanit janë mbajtur 30 takime publike për të cilat janë publikuar 9 njoftime në platformën për qeverisje të mirë. Platforma elektronike ka qenë vështirë e qasshme për shkak të problemeve teknike të cilat i kemi adresuar në takimet në MAPL.

Tabela 3. Raportit për konsultimet publike me shkrim apo elektronike për projektaktet komunale (përdorimi i platformës së konsultimeve publike dhe në ueb të komunës)

Tabela e përgjithshme					
Komuna	Numri total i akteve komunale të miratuara, për të cilat kërkohet organizimi i konsultimit publik	Numri i projektakteve për të cilat është organizuar konsultim publik në platformën e konsultimeve	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar komente gjatë konsultimit	Numri i rekomandimeve/propozimeve të pjesëmarrësve të aprovuara	Numri i raporteve të konsultimit të hartuara dhe publikuara në platformën e konsultimeve
Komuna e Gjilanit	1	1	0	0	0

Verifikimi i të dhënave			
Emërtimi i Projektaktit	Data e fillimit të konsultimit	Linku i konsultimit (platforma e konsultimeve, ueb-i i komunës)	Linku i publikimit të raportit
Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave	03.06.2025 deri më 03.07.2025	https://gjilan.rks-gov.net/njoftim-per-procedurat-e-konsultimit-publik-per-planin-nderkomunal-per-menaxhimin-e-integruar-te-mbeturinave-per-regjionin-e-gjilanit-dhe-ferizajit/	0

4. Raporti i dëgjimeve buxhetore me qytetarë

Komuna e Gjilanit gjatë vitit 2025 ka organizuar konsultimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore, Buxhetin 2026 dhe Buxhetimin me Pjesëmarrje.

Tabela 4. Raporti për dëgjimet buxhetore me qytetarë për KAB

Tabela e përgjithshme							
Komuna	Numri i dëgjimeve buxhetore me qytetarë të organizuara	Numri i pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore (në total)	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar propozime	Numri i propozimeve të pranuara	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M. / F)		Numri i procesverbaleve të hartuara dhe publikuara pas takimeve
Komuna Gjilanit	4	62	19	19	41	21	https://gjilan.rks-gov.net/raporti-i-degjimeve-publike-per-kab-2026-2028/

Verifikimi i të dhënave			
Dëgjimi buxhetor për KAB	Data e takimit	Linku i njoftimit të publikuar	Linku i procesverbalit
KAB	13.06.2025	https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-KAB-2025-2027.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/raporti-i-degjimeve-publike-per-kab-2026-2028/

Tabela 5. Raportit për dëgjimet buxhetore me qytetarë për Draft buxhetin

Tabela e përgjithshme							
Komuna	Numri i dëgjimeve buxhetore me qytetarë të organizuar	Numri i pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore (në total)	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar propozime	Numri i propozimeve të pranuar	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M. / F)		Numri i procesverbaleve të hartuara dhe publikuara pas takimeve
Komuna e Gjilanit	13	85	36	123	82	3	Raporti përmbledhës https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/12/Raport-i-Permbledhes-i-Konsultimeve-Publike_KOMUNA-GJILAN_DEMOS-1.docx

Verifikimi i të dhënave			
Dëgjimi buxhetor për Draft Buxhetin	Data e takimit	Linku i njoftimit të publikuar	Linku i procesverbalit
Draft Buxheti	23.07.2025 deru më 30.07.2025	https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Kalendari-i-Degjimeve-Buxhetore-per-Planifikimin-Buxhetor-2026-2028-3.pdf	https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/12/Raport-i-Permbledhes-i-Konsultimeve-Publike_KOMUNA-GJILAN_DEMOS-1.docx

Tabela 6. Raportit për dëgjimet buxhetore me qytetarë në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje

Tabela e përgjithshme							
Komuna	Numri i dëgjimeve buxhetore me qytetarë të organizuara	Numri i pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore (në total)	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar propozime	Numri i propozimeve të pranuar	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M. / F)		Numri i procesverbaleve të hartuara dhe publikuara pas takimeve
Komuna e Gjilanit	16	127 pjesëmarrës morën pjesë në takimet e para- fazën e propozimeve 138 pjesëmarrës morën pjesë në takimet e dyta- fazën e votimeve	27	32	110 në takimet e para dhe 108 në takimet e dyta	17 në takimet e para dhe 30 në takimet e dyta	Raporti i Buxhetimit me pjesëmarrje https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Raport-i-Buxhetimit-me-Pjesemarrje-2025.pdf